L I G J
Nr. 8860, datë 7.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE PËR RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E DHËNA MË PARË

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për rregullimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse për kreditë e dhëna më parë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3267, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE
PËR RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NDAJ FERDERATËS RUSE PËR KREDITË E DHËNA MË PARË

HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Federatës Ruse, të quajtura më poshtë Palë,

në përputhje me kushtet e Memorandumit shumëpalësh mbi reduktimin dhe ristrukturimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë (më tej quhet Memorandumi shumëpalësh), nënshkruar më 22 korrik të vitit 1998 në qytetin e Parisit nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve kreditore pjesëmarrëse të Klubit të Parisit,

duke pasur parasysh kushtet e asociimit të Federatës Ruse në veprimtarinë e Klubit të Parisit me cilësinë e shtetit kreditor me të drejta të plota,

me qëllimin e zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve,

ranë dakort për sa më poshtë:

Neni 1
Kategoritë e borxhit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të përdoren në borxhin për kreditë shtetërore me afat shlyerjeje me shumë se një vit, të cilat i janë dhënë apo garantuar nga Qeveria e ish BRSS-së ose nga

institucionet e saj përkatëse Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose institucioneve të saj përkatëse ose janë mbuluar nga garancia e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose institucioneve të saj përkatëse (më tej quhen kredi shtetërore).

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në kategoritë e përmendura të borxhit, pavarësisht nga kushtet e shlyerjes të vendosura në marrëveshjet e kredive.

Neni 2

Shumat e rregulluara

1. Shuma e përgjithshme e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Federatës Ruse, sipas principalit dhe interesave, sipas kredive shtetërore të dhëna më parë përbën shumën 142.818.499,64 rubla sipas gjendjes më 1 maj 1998.

2. E gjithë shuma e borxhit e shprehur në rubla, i nënshtrohet konvertimit në dollarë amerikanë mbi bazën e kursit zyrtar të rublës të Bankës Shtetërore të BRSS-së, që është 0,6 rubla për 1 dollar amerikan.

Duke u nisur nga kjo, shuma e përgjithshme e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse arrin shumën 238.030.832,73 USD sipas gjendjes më 1 maj 1998.

3. Shtatëdhjetë për qind e shumës së borxhit sipas principalit dhe interesave, të shprehura në USD dhe të treguara në pikën 2 të këtij neni, nuk do të paguhet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Tridhjetëpërqindëshi i mbetur i këtij borxhi do të shlyhet në përputhje me këtë Marrëveshje.

Ky reduktim fillestar i borxhit të kërkuar nga Federata ndaj Republikës së Shqipërisë do të hyjë në fuqi ligjore nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

4. Shuma e borxhit sipas principalit dhe interesave, që është objekt i kësaj Marrëveshjeje (më tej quhet shumat e rregulluara), duke përfshirë pagesat që u ka kaluar afati, tregohet në shtojcën nr.1, e cila është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje,

Neni 3

Konsolidimi

1. Pesëdhjetë për qind e shumave të rregulluara që i nënshtrohet shlyerjes sipas gjendjes më 1 maj 1998, inkluzivisht, nuk do të paguhet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Pesëdhjetë përqindëshi i mbetur i shumave të rregulluara që i nënshtrohet shlyerjes sipas gjendjes më 1 maj 1998, inkluzivisht, do të konsolidohet në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Shumat e rregulluara të konsoliduara në përputhje me pikën 1 të këtij neni (më tej quhen shuma të konsoliduara), tregohen në shtojcën nr.2, e cila është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Shlyerja e shumave të konsoliduara

Shumat e konsoliduara do të shlyhen në dollarë amerikanë, në përputhje me grafikun e parashikuara në shtojcën nr.3, e cila është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Maturimi dhe pagesa e interesave

1. Në çdo shumë të konsoliduar, të treguar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, të shprehur në dollarë amerikanë, duke filluar që nga 1 maji 1998, do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6-mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

2. Interesat do të maturohen çdo gjashtë muaj dhe do të paguhen në dollarë amerikanë, më 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti; ndërkaq pagesa e parë do të kryhet më 1 nëntor 1998, kurse pagesa e fundit do të kryhet njëkohësisht me pagesën e fundit për shlyerjen e shumave të konsoliduara.

3. Interesat do të maturohen mbi bazën e sasisë faktike të ditëve të rrjedhura gjatë vitit me 360 ditë. Ndërkohë do të përdoren kuoatat LIBOR që veprojnë dy ditë pune para fillimit të çdo periudhe përkatëse 6-mujore për llogaritjen e interesave (më tej quhet periudha e interesave).

Neni 6
Interesat për borxhin që i ka kaluar afati

Në rastin kur çdo pagesë për shlyerjen e shumave të konsoliduara dhe interesave, të treguara në nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje, nuk është kryer në afatin e caktuar, ky borxh shpallet i vonuar dhe për të maturohen interesa sipas kuotës LIBOR, që vepron në periudhën e interesave korresponduese plus marzhin në masën katër për qind në vit, nga data e krijimit të borxhit të vonuar deri në datën e shlyerjes së plotë të kësaj pjese të borxhit, inkluzivisht.

Neni 7
Agjentët/procedurat

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Veprimtarisë së Jashtme Ekonomike e BRSS-së (që më tej quhet "Vneshekonombank") janë agjentë të plotfuqishëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse, përkatësisht. Për qëllime të realizimit të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha pagesat për shlyerjen e borxhit sipas principalit dhe interesave do të bëhen nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, për llogari të Ministrisë së Financave të Federatës Ruse në "Vneshekonombank", sipas kërkesës së kësaj të fundit. Rregulli i llogaritjes dhe kalkulimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të përcaktohet në marrëveshjen përkatëse midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe "Vneshekonombank".

Neni 8
Kushtëzimi

Në rast se Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të plotësojë kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të Memorandumit shumëpalësh, mbi çka Kryetari i Klubit të Parisit paraprakisht lajmëron Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, kushtet e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje ndërpresin veprimin e tyre dhe do të shpallen të paqena, ndërsa borxhi i konsoliduar, në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me interesat e maturuara në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje, do të shpallen në afat shlyerjeje (duke marrë parasysh pagesat për principalin dhe interesat, të cilat tashmë janë kryer), me përjashtim të pagesave, afatet e shlyerjes së të cilave, të përcaktuara në marrëveshjet e kredive origjinale, ende nuk kanë mbërritur.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit mbi kryerjen e procedurave të brendshme shtetërore, të domosdoshme për hyrjen e saj në fuqi dhe e ndërpret veprimin e saj nga data e plotësimit të plotë nga Pala Shqiptare të detyrimeve që ajo ka sipas kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Moskë më 26 nëntor 2001 në dy kopje, secila në gjuhën shqipe dhe ruse, duke pasur të dy tekstet juridike të barabartë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E FEDERATËS RUSE

SHTESË
PËR MARRËVESHJEN MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Federatës Ruse, të quajtura më poshtë Palë,

në përputhje me kushtet e Memorandumit shumëpalësh për reduktimin dhe ristrukturimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë (më tej quhet Memorandum shumëpalësh), nënshkruar më 14 tetor 1999 në Paris nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve kreditore, pjesëmarrës të Klubit të Parisit, ranë dakort të bëjnë ndryshimet e mëposhtme në Marrëveshjen midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse mbi rregullimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse për kreditë e akorduara më parë, datë 26 nëntor 2001 (më tej quhet Marrëveshje).

Neni 1
Konsolidimi

Në përputhje me këtë Shtesë do të konsolidohen kategoritë e mëposhtme të borxhit (më tej quhen shumat e konsoliduara sipas Shtesës).

1. Interesat e maturuara mbi shumat e konsoliduara, në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes (duke përfshirë interesat për pagesat që u ka kaluar afati të maturuara në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes), që i nënshtrohen shlyerjes sipas gjendjes më 31 Mars 1999 dhe që nuk janë paguar.

2. Interesat e maturuara mbi shumat e konsoliduara në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes (duke përjashtuar interesat për pagesat që u ka kaluar afati, të maturuara në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes), që i nënshtrohen shlyerjes nga 1 prilli 1999 deri 30 qershor 2000 dhe që nuk janë paguar.

Neni 2
Shlyerja e shumave të konsoliduara sipas Shtesës

Shumat e konsoliduara sipas Shtesës do të shlyhen në dollarë amerikanë me dhjetë pagesa të barabarta 6-mujore, ndërsa pagesa e parë do të kryhet më 30 qershor 2001 dhe pagesa e fundit më 31 dhjetor 2005.

Neni 3
Maturimi dhe pagesa e interesave

1. Për çdo shumë të konsoliduar sipas Shtesës, të paraqitur në pikën 1 të nenit 1 të kësaj Shtese, duke filluar nga 1 prilli 1999, çdo gjashtë muaj do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6-mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

Për çdo shumë të konsoliduar sipas Shtesës, të paraqitur në pikën 2 të nenit 1 të kësaj Shtese, duke filluar nga data e pagesës e përcaktuar nga nenet 4 dhe 5 të Marrëveshjes, çdo gjashtë muaj do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6 - mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

2. Interesat e treguara në pikën 1 të këtij neni, që janë maturuar nga data 1 prill 1999 deri 30 qershor 2000, do të konsolidohen dhe paguhen në përpuhtje me grafikun e treguar në nenin 2 të kësaj Shtese.

3. Në interesat e konsoliduara të treguara në pikën 2 të këtij neni, duke filluar nga 1 korrik 2000, çdo gjashtë muaj do të maturohen interesat sipas kuotës LIBOR për depozitat 6-mujore në dollarë amerikanë plus marzhin në masën dy për qind në vit.

4. Interesat e treguara në pikën 1 dhe 3 të këtij neni, me përjashtim të atyre të treguara në pikën 2 të këtij neni, do të paguhen në dollarë amerikanë më 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti dhe pagesa e parë e interesave do të kryhet më 30 qershor 2001, kurse pagesa e fundit do të kryhet njëkohësisht me pagesën e fundit për shlyerjen e shumave të konsoliduara sipas Shtesës.

5. Interesat do të maturohen mbi bazën e sasisë faktike të ditëve të rrjedhura gjatë vitit me 360 ditë. Në këtë rast, do të përdoren kuotat LIBOR që veprojnë dy ditë pune para fillimit të çdo periudhe përkatëse 6-mujore për llogaritjen e interesave (më tej quhet periudha e interesave).

Neni 4
Interesat për borxhin që i ka kaluar afati

Në rast se çdo pagesë për shlyerjen e shumave të konsoliduara sipas Shtesës dhe pagesa e

interesave, të parqitura në nenin 3 të kësaj Shtese, nuk kryhet në afatet e përcaktuara, ky shpallet borxh që i ka kaluar afati dhe mbi të maturohen interesa sipas kuotës LIBOR, që vepron në periudhën përkatëse të interesave plus marzhin në masën katër për qind në vit, që nga momenti i krijimit të borxhit që i ka kaluar afati deri në datën e shlyerjes së plotë të kësaj pjese të borxhit, inkluzivisht.

Neni 5
Ruajtja e të drejtave

Kjo Shtesë është pjesë e pandarë e Marrëveshjes. Dispozitat e Marrëveshjes do të ruajnë fuqinë e tyre për pjesën që nuk është ndryshuar nga kjo Shtesë.

Termat e përcaktuara në Marrëveshje bartin po atë kuptim si dhe në këtë Shtesë.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Shtesë hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit mbi kryerjen e procedurave të brendshme shtetërore, të domosdoshme për hyrjen e saj në fuqi dhe e ndërpret veprimin e saj nga data e plotësimit të plotë nga Pala Shqiptare të detyrimeve që ajo ka sipas kësaj Shtese.

Në qoftë se ndonjë pagesë e parashikuar nga kjo Shtesë duhet të ishte kryer para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Shtese, pagesa e përmendur (duke përjashtuar interesat për vonesat e maturuara, në përputhje me nenin 4 të kësaj Shtese), do të kryhet në datën më të afërt pasardhëse të parashikuar nga kjo Shtesë, por në çdo rast jo më vonë se 31 dhjetor 2001.

Bërë në Moskë më 26 nëntor 2001, në dy kopje secila në gjuhën shqipe dhe ruse, duke patur dy tekstet fuqi juridike të barabartë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E FEDERATËS RUSE

SHTOJCA NR.1
E MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

Shumat e borxhit të rregulluar të Republikës së Shqipërisë për kreditë e akorduara më parë sipas gjendjes më 1.5.1998

Data e Marrëveshjes së kredisë	Numri i llogarisë së kredisë	Madhësia e borxhit (në valutën e kredisë)	Madhësia e borxhit (USD)	Madhësia e shumave të rregulluara (USD)
21.07.54	128	3 983 207,11	6 638 678,52	1 991 603,56
18.07.55	163	1 408 506,73	2 347 511,22	704 253, 37
23.03.56	187	11 952 463,57	19 920 772,62	5 976 231,79
26.06.56	194	21 661 666,72	36 102 777,87	10 830 833,36
17.04.57	223	11 092 854,02	18 488 090,03	5 546 427,01
22.11.57	237	63 733 890,91	106 223 151,52	31 866 945,46
06.02.59	275	13 968 750,00	23 281 250,00	6 984 375,00
03.07.59	283	11 853 754,33	19 756 257,22	5 926 877,17
25.07.59	286	3 163 406,25	5 272 343,75	1 581 703,13
Gjithsej		142 818 499,64	238 030 832,75	71 409 249,85

GJITHSEJ: 71 409 249,85

SHTOJCA NR.2
E MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

Shumat e borxhit të konsoliduar të Republikës së Shqipërisë për kreditë e akorduara më parë sipas gjendjes më 1.5.1998

Data e Marrëveshjes së kredisë	Numri i llogarisë së kredisë	Madhësia e borxhit (në valutën e kredisë)	Madhësia e borxhit (USD)	Shumat e borxhit të rregulluar (USD)	Shumat e borxhit të konsoliduar (USD)
21.07.54	128	3 983 207,11	6 638 678,52	1 991 603,56	995 801,78
18.07.55	163	1 408 506,73	2 347 511,22	704 253,37	352 126,69
23.03.56	187	11 952 463,57	19 920 772,62	5 976 231,79	2 988 115,90
26.06.56	194	21 661 666,72	36 102 777,87	10 830 833,36	5 415 416,68
17.04.57	223	11 092 854,02	18 488 090,03	5 546 427,01	2 773 213,51
22.11.57	237	63 733 890,91	106 223 151,52	31 866 945,46	15 933 472,73
06.02.59	275	13 968 750,00	23 281 250,00	6 984 375,00	3 492 187,50
03.07.59	283	11 853 754,33	19 756 257,22	5 926 877,17	2 963 438,59
25.07.59	286	3 163 406,25	5 272 343,75	1 581 703,13	790 851,57
Gjithsej		142 818 499,64	238 030 832,75	71 409 249,85	35 704 624,95

GJITHSEJ: 35 704 624,95

SHTOJCA NR.3
E MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE MBI RREGULLIMIN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ FEDERATËS RUSE PËR KREDITË E AKORDUARA MË PARË

Grafik
i shlyerjes së shumave të konsoliduara të borxhit

Nr.	Pjesa e principalit	Shuma e pagesës në		Data e pagesës	Nr	Pjesa e principalit	Shuma e pagesës në USD		Data e pagesës
		Principali	Interesat				Principali	Interesat	
1	0.00	0.00	1425705.51	01.11.98	2	0.00	0.00	1251612.13	01.05.99
3	0.00	0.00	1288381.56	01.11.99	4	0.00	0.00	1468196.49	01.05.00
5	0.00	0.00	1568504.17	01.11.00	6	0.00	0.00	1561779.80	01.05.01
7	0.00	0.00	1142161.20	01.11.01	8	0.00	0.00		01.05.02
9	0.00	0.00		01.11.02	10	0.00	0.00	-	01.05.02
11	0.00	0.00	-	01.11.03	12	0.00	0.00	-	01.05.04
13	0.12	42845.55	-	01.11.04	14	0.20	71409.25	-	01.05.06
15	0.28	99972.95	-	01.11.05	16	0.38	135677.58	-	01.05.06
17	0.48	171382.2	-	01.11.06	18	0.58	207086.83	-	01.05.07
19	0.70	249932.38	-	01.11.07	20	0.82	292777.93	-	01.05.08
21	0.94	335623.47	-	01.11.08	22	1.08	385609.95	-	01.05.09
23	1.22	435596.42	-	01.11.09	24	1.36	485582.90	-	01.05.10
25	1.52	542710.30	-	01.1.10	26	1.70	606978.62	-	01.05.11
27	1.86	664106.02	-	01.11.11	28	2.06	735515.27	-	01.05.12
29	2.26	806924.52	-	01.11.12	30	2.46	878333.77	-	01.05.13
31	2.68	956883.95	-	01.11.13	32	2.92	1042575.05	-	01.05.14
33	3.18	1135407.07	-	01.11.14	34	3.44	1228239.10	-	01.05.15
35	3.70	1321071.12	-	01.11.15	36	4.00	1428185.00	-	01.05.16
37	4.30	1535298.87	-	01.11/16	38	4.64	656694.60	-	01.05.17
39	4.98	1778090.32	-	01.11.17	40	5.34	1906626.97	-	01.05.18
41	5.72	2042304.55	-	01.11.18	42	6.12	2185123.05	-	01.05.19
43	6.54	2335082.47	-	01.11.19	44	7.00	2499323.75	-	01.05.20
45	7.46	2663565.02	-	01.11.20	46	7.96	2842088.15	-	01.05.21

35704624.95 9706340.86

(-) Interesat llogariten kur fillon periudha përkatëse e interesave.